



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Priljeno:	03. 06 20 24	
Mjësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
05-453/01-27167		



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale Nr.03/L-040- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 Qershor 2008, Rregullores MF-NR- 04/2017 mbi Kriteret, Standartet dhe procedurat e financimit public të OJQ-ve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i dates 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS merr këtë:

### VENDIM PËR SHPALLJE TË THIRRJES PUBLIKE PËR OJQ

#### I

Për shpalljen e Thirrjes Publike për mbështetje financiare publike për projekte/programet të Organizatave Joqeveritare në fushën e Kulturës dhe rinisë.

#### II

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF-Nr – 04/2017 Mbi Kriteret, Standartet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet Buxheti i Komunës (DKRS) kodi ekonomik 85003 SUBVENCIONE në kuadër të programit për KULTURË DHE RINI.

#### III

1.Mjetet e përmendura në nenin do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë e këtij vendimi.

## IV

### **1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikes II. Të këtij vendimi përfshinë:**

1. Teksti i thirrjes publike
2. Udhëzimet për aplikantët
3. Formularët e aplikimit
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
5. Forma për raportimin e zbatimit të projektit

### **2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:**

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta
4. Deklarata e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike
6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).

### **3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:**

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrative për projektin apo programin
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

## V

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (web faqe)

## VI

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standartet dhe procedurat e financimit public për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Antarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

## VII

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

## VIII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Lipjan, 03/06/2024

**Anila Reçica Llugiqi**  
**Drejtoreshë e DKRS-së**

